

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “
Zija Vuci,	Anëtar i “
Alfred Karamuço,	Anëtar i “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “
Kujtim Puto,	Anëtar i “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “
Hajredin Fuga,	Anëtar i “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.7.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen me nr.të Aktit, që i përket :

KËRKUES: AVOKATI I POPULLIT, përfaqësuar ng z . Ermir Dobjani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

- 1.KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë
- 2.KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë

O B J E K T I

Interpretimi i pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe në kërkesën e tij .

Ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përshihet edhe Avokati i Popullit , por sipas nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, kërkesën mund ta bëjë “vetëm, për çështje që lidhen me interesat e tij”. Përcaktimi nëpërmjet interpretimit, të rrethit të çështjeve që përbëjnë interesa të “Avokatit të Popullit, në këtë moment paraqet rëndësi për funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Këto interesa mund të ishin:

Çështjet, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve apo grup individësh , siç përcaktohet në nenin 60, pika 1 e Kushtetutës dhe Ligji nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Çështjet që lidhen me pavarësinë e tij në ushtrimin e funksionit, që përcaktohen në nenin 60, pika 2 e 63 të Kushtetutës dhe ligjit organik “Për Avokatin e Popullit”.

Çështjet, që kanë të bëjnë me buxhetin, strukturën, organikën, pagat, etj.

Çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e zgjedhjes, imunitetin e pagës, kohëzgjatja në detyrë dhe papjatushmërinë në këtë funksion, që parashikohen nga nenet 61 e 62 të Kushtetutës dhe nga ligji organik.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi kërkuesin si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Sipas nenit 134 të Kushtetutës, subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe; në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte, që mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim, del nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 134 të Kushtetutës dhe në këtë kategori subjektësh që mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të kushtëzuar, përfshihet edhe Avokati i Popullit. Më konkretisht, në pikën 2 të nenit 134 thuhet: ” subjektet e parashikuara në paragrafet dh..... të paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen

për interesat e tyre”.

Sipas nenit 131 të Kushtetutës dhe të neneve të tjera të saj, në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese përfshihen mjaft çështje për të cilat kjo vendos, por nga fryma e Kushtetutës që gjen zbatim në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë “Avokati i Popullit ka të drejtë të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare (neni 49), për pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me kushtetutën (neni 52) dhe për interpretimin e Kushtetutës (neni 71), gjithnjë kur çështja lidhet me interesat e tij.

Në bazë të paragrafit të parë, të nenit 60 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka për funksion të tij “të mbrojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”. Në këtë kuptim, me çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit do të jenë pikërisht ato çështje, që lidhen me këtë funksion kushtetues të ngarkuar Avokatit të Popullit, kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, e aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, këto interesa janë cënuar duke shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, shkelje këto, të konstatuara në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij.

Kushtetuta, në nenin 60, paragrafi 2 e 3, në nenin 61 dhe 62 të saj, vendos rregulla të organizimit dhe të funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit. Në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës, me interesa të Avokatit të Popullit do të konsiderohen edhe rastet e cënimit të këtyre rregullave kushtetuese, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit, pavarësisht, nëse janë vërtetuar ose jo pasojat.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 134, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenet 71, 72 dhe 79 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

V E N D O S I

1. Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës mund t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rastet e parashikuara në nenet 49, 52 dhe 71 të ligjit 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cënuar rregullat kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e institucionit të tij.

2. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi nga miratimi i Kushtetutës.

U shpall sot më datë 31.07.2000

Nr.51 i Rregj. Themeltar

Nr. 49 i Vendimit.